



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. 2-D/DPK
Nr. Prot. Prot. No. 01-428/16
Data Datum 03.02.2016
f. faq. f. faq.
Proj. stranica
Nr. pages 02

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.02.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-4295-15, për Zyrtarin e lartë, z.Vehbi Rama-Këshilltar Komunal në Kuvendin e Vitisë, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-4295-15, për Zyrtarin e lartë, z.Vehbi Rama-Këshilltar Komunal-Komuna e Vitisë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Rama është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Rama është deklaruar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Mirëpo, megjithatë z.Rama këtë nuk e ka bërë brenda afatit të parashikuar ligjor, dhe pastaj Agjencioni kundër Korrupsionit i ka bërë edhe shkresën e dytë(Paralajmëruese) në të cilën AKK ka konstatuar konfliktin e interesit dhe i ka dhënë afatin ligjor për ndryshime bashkë me njoftimin se pas këtij afati lënda shkon në Gjykatën kompetente.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell informatë mbi biznesin (DPK/DPKI-03-02-416/16), nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) në të cilat

shihet se te biznesi N.T.P.“Fitore”, z.Rama tashmë ka hequr dorë nga e drejta e të qenurit person i autorizuar, duke emëruar në këtë pozitë një person të besuar, me çka ka shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



/Hasan Preteni /